

2.2. Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kompetencat, përgjegjësit dhe punën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit

Avdyl Aliu- kjo është një rregullore e punuar me kujdes nga përgjegjësit e Komunës e cila i ka kaluar të gjitha fazat e nevojshme duke përfshirë edhe dëgjimin publik i cili është mbajtur më 21 maj të këtij viti. Duhet theksuar se neni 6 i cili ka të bëjë me Komitetin e Ekspertëve të Planifikimit Hapësinor ku bëhen përshkrimi dhe kompetencat të cilat i ka ky komitet. Për këtë komitet janë duke u bërë përgatitjet e posaçme në bashkëpunim me ATRC-në. Grupi i LDK-së e mbështet këtë rregullore dhe kërkon që të aprovohet në këtë seancë.

Sealami Xhemajli- edhe ne në emër të grupit e mbështesim këtë rregullore, është obligim që të aprovohet ko rregullore, sepse u tha se i ka kaluar të gjitha procedurat. Në mënyrë të veçantë përmendet themelimi i dy komiteteve ai për Bashkëpunim Ndërkufitar dhe ai për Barazi Gjinore për të cilat komitete janë paraparë edhe kompetencat. Unë në emër të grupit i jap përkrahje kësaj rregulloreje.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.2.

Aprovohet pika 2.2 e rendit të punës: Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për kompetencat, përgjegjësit dhe punën e Komiteteve të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, me 28 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

2.3 Propozim vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim afatshkurtër (15 vite) personave fizik dhe juridik, ng.kadastrale P-70403013-01345-0

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- pasi që pika 2.3 dhe 2.4 kanë ngjashmëri në mes vete dhe kanë të bëjnë me dhënie të pronës në shfrytëzim, unë propozoj që të dy pikët të diskutohen në bllok.

Aprovohet kërkesa e kryesuese që pika 2.3 dhe 2.4 të diskutohen në bllok me 27 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

Sadudin Berisha- sqarimin për pikën 2.3 dhe 2.4 e dha drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i cili arsyetim është i dorëzuar si material me shkrim.

Nevzad Rushiti- ne jemi pajtuar në Komitet për këto prona që të shfrytëzohen, por pika parë është interes për qytetarët për t' i marrë këto prona në shfrytëzim, por interesi i përgjithshëm është edhe i Komunës. Procedura për dhënie në shfrytëzim të pronës 2.3 është procedurë e ankandit publik. Për pikën 2.4 përsëri kemi të bëjmë me interes të përgjigjëm, sepse KECI i ka paraparë tri trafo për t' instaluar në Komunë të Gjilanit, sepse në ato pjesë do të ketë zhvillim dhe infrastrukturë të qytetit.

Riad Rashiti- unë kam një pyetje se a është bërë vlerësimi paraprak dhe me çfarë vlere do të epej në shfrytëzim kjo pronë? Me ligj përveç kohëzgjatjes së dhënies së pronës në shfrytëzim është paraparë edhe çmimi fillestar gjatë shpalljes së ankandit publik. Kjo është e rregulluar me ligj dhe këtë duhet caktuar këtu dhe jo një komision i cili nuk ka kompetencë për ta vlerësuar se me çfarë çmimi duhet të epet në shfrytëzim kjo pronë?

Arijetë Rexhepi- ne dhe në Komitetin për Pronë kemi bërë pyetje se për çfarë veprimtarie do të epet në shfrytëzim kjo pronë. Në mbledhje të komitetit është thënë se ka të interesuar, prandaj ne kemi bindjen se kjo pronë po i përshtatet një personi të caktuar paraprakisht. Nëse ka individ të caktuar për shfrytëzim të pronës komunale, do të ishte mirë që të epen më shumë prona të tilla në shfrytëzim duke e bërë vlerësimin ekspertët përkatës dhe pas kësaj t' i epet mundësia për të konkurruar ata që dëshirojnë.

Nevzad Isufi- përkitazi me pronën e parë ne edhe në KPF kemi kërkuar një përshkrim më të saktë nga ky që është aktualisht te arsyetimi i dhënies. Besoj se një pjesë e madhe e anëtarëve të Kuvendit do të

dëshironin ta dinin ku është kjo pronë, por jo vetëm kjo, por çdo rast që kemi të bëjmë me prona komunale. Për transparencë më të madhe kjo pronë ka pasur mundësi të paraqitet përmes monitorit për ta ditur të gjithë se ku gjendet kjo pronë?

Te përshkrimi kjo pronë nuk kufizohet me prona të Kombinatit Bujqësor, por kryesisht kufizohet me prona private.

Selvete Shurdhani- sa i përket çështjes së pronës për dhënie në shfrytëzim, dihet se është interes i përgjithshëm i Komunës dhe qytetarëve. Mirëpo unë mendoj që prona e cila propozohet për dhënie në shfrytëzim nuk kufizohet me pronë shtetërore, por kufizohet me pronarë privat, prandaj pronarët që kanë pronë afër duhet të konsultohen dhe duhet të njoftohen lidhur me veprimtarinë e cila do të ushtrohet në atë pronë. Nuk duhet lejuar ndonjë veprimtari e cila do t' i pengonte pronarët të cilët kanë prona afër asaj prone që epet në shfrytëzim.

Sadudin Berisha- në vendim duhet lexuar pikën 2.3,4,5 dhe 6 ku përshkruhen kushtet për dhënie të pronës në shfrytëzim. Nuk ka asnjë rëndësi se me cilat prona kufizohet kjo pronë e cila epet në shfrytëzim? Kjo pronë do të tenderohet dhe kush i plotëson kriteret ai do ta merr në shfrytëzim?

Sa i përket pikës tjetër është kërkesë e KEC-it për dhënie në shfrytëzim disa sipërfaqe të vogla kadastrale për vendosje të trafave e të cilat janë në interes të ekonomive familjare bizneseve dhe ofrimit të shërbimeve më të mira të infrastrukturës të rrjetit elektrik. Këto parcela janë një në Ponesh, rugën Qarkore dhe tjetra te Zabeli i "Sahit Agës"

Riad Rashiti- unë e bëra një pyetje dhe është mirë dhe obligim për të më dhënë përgjigje? Unë përsëri po pyes kush do të vendos për çmimin fillestar i cili duhet të jetë në ankand? Në bazë të ligjit KK duhet të i miratojë kriteret për dhënie në shfrytëzim të pronës? Nuk është mirë të kalojë ky vendim për pa u caktuar çmimi fillestar, sepse paraprakisht me propozim- vendimin do të duhej të vinte edhe çmimi fillestar.

Isa Agushi- pajtohem me Riadin i cili e thotë se çmimi fillestar duhet të dihet, sepse nuk mund një komision të vendos për një çmim. Ne nuk mund ta ngrisim dorën këtu dhe të miratojmë diçka për pa e ditur se çka po miratojmë, atëherë mund të ndodh gjithçka! Pajtohem me Riadin.

Nevzad Rushiti- unë jam pjesë e atij komisioni dhe ai komision e ka bërë edhe ankandin e parë për parkingjet. Ky komision e ka vlerësuar çmimin fillestar dhe është shpall ankandi, prandaj unë mendoj se dhe kjo procedurë me këtë rast duhet ta kryejë ky komision. Mirëpo unë bëj një kërkesë te grupi i PDK-së që ta dërgojë anëtarin e vetë në këtë komision, sepse ende nuk e ka dërguar.

Riad Rashtiti- unë përsëri po e them se Kuvendi e ka marrë një vendim dhe e ka formuar një komision, por ne nuk jemi pjesë e atij komisioni dhe i kemi arsyet pse nuk jemi pjesë e atij komisioni. Ky komision nuk është kompetent për t' i zhvilluar procedurat e ankandit dhe përzgjedhjen e ofertuesit më të mirë.

Ka ndodhur kështu në të kaluarën, por ka ndodhur keq dhe ka qenë shkelje ligjore. Ne nuk dërgojmë anëtarë në një komision ku nuk respektohen procedura dhe kriteret ligjore.

Nevzad Rushiti- Kuvendit sot vendos se a do të epet prona e komunës në shfrytëzim, kurse procedurat tjera zbatohen sipas ligjit, sepse është edhe komisioni për ankand publik dhe ai për ankesa. Tërë procedurën komisioni e zbaton në bazë të ligjit.

Valentinë Bunjkau-Rexhepi – unë kërkoj sqarim për këtë rast, prandaj të na jep sqarim Zyra ligjore.

Pas një konsultimi me Sekretarinë e Kuvendit në bazë të paragrafit 6.3 neni 8 për çmimin vendos komisioni. Pas këtij sqarimi kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.3 dhe 2.4 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.3 dhe 2.4 e rendit të punës me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

2.5 Propozim vendimi për themelimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor

Valentinë Bunjkau-Rexhepi- me këtë rast duhet të formohet një komision prej 5 anëtarëve, sepse këto komitete konsultative zgjidhen përmes konkursit publik. Ky komision duhet të formohet sipas fuqisë politike në Kuvend dhe LDK i ka dy emra, PDK 1, AAK 1 dhe Shoqëria Civile 1.

Ne si LDK propozojmë z. Avdyl Aliu dhe Jehonë Hysenin.

Bujar Nevzadi- propozimin që e dha kryesuesja nuk është i mirë, sepse më reale do të ishte që një anëtar ta ketë LDK, 1 PDK, 1 AAK dhe 1 LVV. Sa i përket PDK-së ne e propozojmë Bahrie Mahmutin.

Izmi Zeka- nëse ka të drejtë Shoqëria Civile, pse nuk paska të drejtë një eksperte. Ne dëshirojmë për ta propozuar një eksperte dhe jo person i cili fare nuk e njeh planifikimin hapësinor.

Avdyl Aliu- z. Aliu e sqaron vendimin për themelimin e Komitetit Konsultativ të Ekspertëve dhe thekson se paneli duhet të jetë nga 4 anëtarë nga Kuvendi dhe 1 nga Shoqëria Civile.

Nevzad Isufi- unë mendoj se kolegu z. Zeka ka të drejtë dhe unë e mbështesë mendimin e tij. Nuk është mirë që ju të veproni sipas interesave të juaja, sepse sa herë që t'iu konvenoj thoni se jeni në koalicion, por ka raste kur thoni jemi vetëm. Ne e kemi një emër i cili është profesionist i kësaj lëmie, prandaj nuk e di si ka mundësi që Shoqëria Civile të ketë më shumë të drejtë se një anëtar i Kuvendit i zgjedhur nga populli.

Valentinë Bunjkau-Rexhepi – pse AAK dhe jo LVV po bëhet pyetje? Kjo është, sepse të dy grupet kanë ulëse të barabarta në Kuvend, por AAK ka numër më të madh të votuesve.

Mevludë Zejnullahu- në emër të AAK-së e propozojmë z. Selami Xhemajlin

Bujar Nevzadi- ju qeverisjen e keni, drejtorët i keni, është mirë të jeni më tolerantë, sepse nuk është fundi i botës dhe nuk keni pse të frikoheni.

Valentinë Bunjkau-Rexhepi- kush është që të zgjidhet ky komision pa emrin e PDK-së, kurse Shoqëria Civile të na e sjell emrin pas dy dite?

Aprovohet pika 2.5 e rendit të punës: Propozim vendimi për themelimin e panelit për përzgjedhjen e anëtarëve të Komitetit konsultativ të ekspertëve të planifikimit hapësinor, me 19 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 4 ishin kundër, të tjerët abstenuan.

2.6 Rekomandim i Komitetit për Arsimit për ndarjen e bursave për nxënës të klasave të X-ta në SHML të Agrobiznesit “Arbëria” në Gjiilan

Nazmi Musa- arsyetim për ndarjen e bursave për Shkollën e Mesme të Agro-Biznesit e dha drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Nazmi Musa i cili theksoi se për ta bërë këtë shkollë më tërheqëse dhe për t'iu nxit nxënësve që të regjistrohen në këtë shkollë kemi vendosur që t'iu ndajmë disa bursa, por mundësisht edhe të rregullohet infrastruktura rrugore në drejtim të kësaj shkolle. Ka disa vite që në këtë shkollë regjistrohet një numër i vogël i nxënësve dhe ndarja e disa bursave do të jetë si masë stimulative për regjistrim në këtë shkollë.

Valentinë Bunjkau-Rexhepi- sqarimet e duhura u dhanë, por ekziston edhe komisioni për ndarjen e bursave i propozuar nga Kuvendi, prandaj i njëjti komision të jetë edhe për ndarje të bursave për nxënësit e Shkollës së Agro- Biznesit.

Shukrie Rapuca- unë e falënderoj drejtorin e Drejtorisë së Arsimit për këtë ide kaq të mirë dhe të qëlluar, sepse kjo është mundësi e stimulimit për të gjithë ata nxënës të cilët janë të shkëlqyeshëm e që dëshirojnë të regjistrohen në këtë shkollë. Unë këtë propozim e kam përkrahur edhe në Komitetin e Arsimit, por i kam pasur dy kërkesa; një që të rritet numri i nxënësve të cilët do të përfitojnë bursë dhe e dyta që të rritet e vlera e shumës së bursës, sepse kjo do të ishte një nxitje më e madhe për t' u regjistruar në këtë shkollë. Gjithashtu kësaj forme stimuluese duhet t' i bashkëngjitet edhe informimi i shpeshtë për rëndësinë e kësaj shkolle. Sa i përket informimit duhet falënderuar TV-në e cila pak ditë më parë ka dhënë një informatë shumë të pasur dhe me shumë informacione për kushtet dhe rëndësinë kuadrit që përgatit kjo shkollë. E falënderoj drejtorin duke dëshiruar që ai të punojë edhe më tepër për stimulim të nxënësve për t' u regjistruar në këtë shkollë.

Bujar Nevzadi- unë përkrahi këtë ide, por edhe në komitet e kemi përkrah ndarjen e bursave për këtë shkollë, por i kam disa shqetësime, sepse po ndodhin disa gjëra që nuk duhet të ndodhin; nën një është kërkesë për shtije të viçave nga 1 janari tash pas gjashtë muajve. Marrëveshja ka qenë që ata viça t' i epen shkollave të tjera ashtu si i kemi marrë donacion.

Nën dy ka qenë e paraparë që ta rregullojmë edhe kuzhinën e cila është e rregulluar, por ka mbetur për 100 metra kabull të rrymës për pa hyrë në funksionim. Këta viça ka qenë e paraparë që të prehen aty dhe të përpunohen, sepse aty është edhe drejtimi për përpunimin e mishit.

Në këtë shkollë nuk funksion kabineti i kimisë dhe kabinetet e tjera. Nga ko shihet se Drejtoria Komunale e Arsimit dhe kryetari i Komunës nuk kanë qenë të interesuar për ta përkrahur shkollën bujqësore.

Sa i përket ndarjes së bursave e përkrahim këtë propozim, por kërkojmë që të rritet numri i bursave dhe jo të jetë një numër simbolik sa për të thënë se po bëjmë diçka.

Fehmi Sylejmani- ko çështje është diskutuar në Komitetin për Arsim dhe unë këtë iniciativë e kam quajtur një prej ideve më kreative të kësaj qeverisje që nga fillimi i punës së saj. Mirëpo unë më parë e thash dhe po e përsëris se nëse këto 50 mijë € që janë subvencion e të cilat kanë qenë të parapara për bursat e studentëve dhe nëse këto 50 mijë € i ndajmë për nxënësit e kësaj shkolle, atëherë nuk del matematika se do të ketë bursa për studentë!? Për këtë arsyeje unë kam kërkuar që shifra në subvencione të rritet nga 50 mijë në 100 mijë € në mënyrë që të ketë bursa edhe për nxënësit e Agro- Biznesit, por edhe për studentët, në të kundërtën asnjë studentë nuk do të përfitojë bursë.

Sa i përket komisionit për ndarje të bursave, unë jam i mendimit që DKA vetë ta zgjedh një komision për këtë çështje, por nëse është komisioni për studentë, atëherë ai komisioni mund t' i shqyrtojë të dy këto raste.

Arben Maliqi- të gjithë jemi të pajtimit se drejtori është duke e bërë një punë të mirë, sepse i ka edhe disa ide kreative të cilat i ka bërë edhe më herët e të cilat kanë ndikuar në rritje të cilësisë së arsimit.

Sa i përket këtij propozimi është shumë i qëlluar, sepse është një stimulim për regjistrim në këtë shkollë, sepse kjo shkollë ka probleme. Mirëpo nuk mund vetëm këto bursa të ndikojnë pozitivisht, por duhet pasur një infrastrukturë të mirëfilltë, sepse ajo shkollë është mjaft larg qendrës, prandaj duhet pasur parasysh rrugën, ndriçimin, sigurimin e nxënësve dhe bartjen e nxënësve. Bartja nuk duhet të jetë vetëm një shkuarje dhe ardhje, por kjo të ndodh disa herë në ditë. Për këtë rast duhet edhe një mobilizim i tërësishëm i të gjitha strukturave komunale, këshillit të prindërve, shoqërisë civile për të kontribuar për regjistrim të nxënësve në atë shkollë. Në fund unë mendoj se duhet ta kemi parasysh edhe planin "B", sepse nëse nuk kemi numër të mjaftueshëm të nxënësve në atë shkollë, atëherë shtrohet pyetja se çka do të ndodh me ata mësimdhënës të asaj shkolle?

Është një ide solide, duhet përgëzuar këtë iniciativë, por duhet edhe më tepër mobilizim, sepse rëndësinë e kësaj shkolle ende nuk po dimë.

Shpresë Kurteshi- ne si grup i LDK-së e kemi shqyrtuar këtë propozim për dhënie të bursave për nxënësit e Shkollës së Agro-Biznesit me qëllim të stimulimit të tyre për t' i vijuar mësimet në këtë shkollë. Ne në emër të grupit të LDK-së e mbështesim këtë propozim dhe do ta votojmë.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja propozon që të aprovohet pika 2.6 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.6 e rendit të punës: Rekomandim i Komitetit për Arsim për ndarjen e bursave për nxënësit të klasave të X-ta në SHML të Agrobiznesit “Arbëria” në Gjilan, me 30 vota të anëtarëve të Kuvendit, nuk kishte kundër as abstenime.

2.7 Informatë rreth vërshimeve në Komunën e Gjilanit

Rexhep Kadriu- informatën për dëmet që iu kanë bërë ekonomive familjare dhe bizneseve, por edhe institucioneve nga të reshurat e shumta të shiut gjatë këtij viti e dha zv/kryetari i Komunës. Z. Rexhep Kadriu, por e cila informatë iu është dërguar me shkrim edhe selive të partive politike në Gjilan.

Riad Rashiti- fillimisht iu falënderoj se iu keni përgjigj kësaj kërkesë “ shumë shpejtë”, brenda 10 muajve e cila është deshtë të sillet brenda dy javëve, por edhe pse ka qenë lehtë për ta sjell këtë informatë, por komisioni nuk e ka kryer punën. Ky raport (informatë), ka të bëjë me reshjet e shumta të shiut të cilat kanë ndodhur gjatë këtij viti 2014, por brenda kësaj informate janë paraqitur edhe dëmet që janë bërë gjatë këtij viti. Ky raport ka qenë desh të jetë më i qartë dhe më specifik, sepse mungojnë shumë informacione të cilat kryetari i paraqiti sidomos për bizneset e dëmtuara , fushat sportive dhe për disa (tri shtëpi të cilat janë dëmtuar në masë të madhe. Këto gjëra nuk janë në raport, prandaj është deshtë që këto të dhëna të jenë pjesë e këtij raporti, sepse kryetari lexoi diçka tjetër, kurse në raport mungojnë.

Te tabela e parë të puseve të cilat janë dëmtuar më 2014, është bërë vlerësim, është dhënë data e vizitës, por nuk është paraqitur përshkrimi se sa dhe në çka janë dëmtuar familjet?

Te bujqësia gjërat janë paraqitur mirë, është paraqitur vendi dhe rendimentet se cilat janë dëmtuar, por si total kur mblidhen nuk del shuma absolutisht 1.6 milion €, por është shumë më pak. Mirëpo me rëndësi është se çfarë premtimi është dhënë për pagesën e këtyre dëmeve. Në Gjilan edhe më parë ka pasur dëme nga fatkeqësitë natyrore, sidomos nga breshëri, por ato dëme janë paguar për një kohë shumë të shkurtër dhe të gjithë qytetarët janë kompensuar nga dëmet që i kanë pasur nga dëmet e breshëri. Këtë vit nuk ka asnjë hap serioz përpos deklaratave politike që kanë dal nga Komuna për kërkesën që ia kanë bërë Qeverisë së Kosovës për ta bërë kompensimin, asnjë lëvizje tjetër nuk është bërë. Edhe pse kryeministri ka qenë në Gjilan, ju këtë çështje nuk e keni riaktivizuar këtë çështje dhe kjo të merret shumë seriozisht nga Qeveria dhe të paguhet dëmet. Në fund unë po ia bëj një pyetje zv/kryetarit se a janë gjasat reale që Qeveria t' i përgjigjet kërkesës së Komunës së Gjilanit për kompensim të këtyre dëmeve?

Avdyl Aliu- unë i shpreh mirënjohje komisionit për përgatitjen e kësaj informate, por po them sipas matematikës që e zbatoj unë e demanton atë shifrën 10 muaj të cilën e thotë z. Rashiti. Ne e dimë se vërshimet kanë ndodhur me 31 korrik 2014 dhe më 22 gusht e që i bie 22 ditë dhe pas 22 dite ne e kemi marrë një informatë nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim gjegjësisht drejtori Halit Rexhepi. Në vijim të fjalës së tij z. Aliu e lexon edhe njoftimin e drejtorit Halit Rexhepi e cila iu është dërguar shefave të grupeve politike. Vetëm për 22 ditë është bërë informata e cila i ka 6 faqe informatë dhe është me rëndësi edhe Shërbimi i Zjarrfikësve ka dhënë të dhëna për këtë rast.

Isa Agushi- një nga të dëmtuarit është edhe biznesi i im dhe kjo ka ndodhur me 13.8.2014. Bizneset dhe qytetarët paguajnë taksa komunale, por edhe tatim në pronë. Për këto raste duhet t' i dilet në ndihmë qytetarëve, prandaj vlerësimi i Komisionit është i kotë pa dëmshpërblim! Herëve të tjera mos dilni fare të bëni vlerësime nëse nuk keni mjete? Paraprakisht duhet të siguroheni e ka mjete e pastaj të dilni dhe bëni vlerësime, por nëse nuk ka mjete, mos dilni fare për të humbur kohë.

Selami Xhemajli- unë e përgëzoj komisionin për punën që e ka bërë, sepse iu ka përgjigj kërkesave të qytetarëve për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet. Është një informatë e plotë, por ndërlidhem me atë për dëmet e shkaktuara nga breshëri, sepse kam qenë pjesë e atij Komisioni dhe mjete janë ndarë nga Qeveria. Në këtë rast të dhënat janë, shënimet janë dhe komisioni e ka kryer punën e vetë në mënyrë perfekte. Nga dëmet e breshëri Qeveria i pat ndarë 5 milion €, për kompensime të dëmeve, mirëpo 1 milion e 200 mijë € janë alokuar në buxhet të Komunës e të cilat komisioni i ka shpërndarë qytetarëve që janë dëmtuar nga breshëri.

Sa i përket punës së Komisionit, mendoj se komisioni e ka kryer punën në mënyrën më të mirë të mundshme dhe pritet ndarje e mjeteve me një vendim të Qeverisë.

Nevzad Isufi- unë informatën e kam dëgjuar me kujdes dhe çka do të flasim është kot, sepse është me rëndësi qëllimi final që edhe pas një viti qytetarët e dëmtuar nuk janë kompensuar. Ne gjithmonë jemi të vonuar, por edhe mos kompensimi i deritashëm është një përgjegjësi e dikujt, prandaj krejt atë që mund ta bëjmë është që ne të bëjmë presion që këto dëme të kompensohen me shuma të cilat janë caktuar. Mendoj se edhe këto shuma janë në kufij minimal, sepse një arë e punuar dhe e mbjell me produkte bujqësore nuk krahasohet me një livadh, është për keqardhje që asnjë kompensim nuk është bërë deri më tash.

Edhe unë pajtohem se ky komision ka punuar një kohë të gjatë dhe ka bërë një punë voluminoze, prandaj tash na nevojitet një angazhim më i madh dhe t' i bëjmë presion Qeverisë që kjo punë të mos shkojë kot.

Rexhep Kadriu- i kuptoj anëtarët e Kuvendit, sepse njerëzit janë dëmtuar, ekonomitë familjare janë dëmtuar, bizneset gjithashtu etj. Mirëpo detyrë e këtij komisioni ka qenë evidentimi dhe si t' i zgjidhim problemet në të ardhmen. Këto dy obligime kanë qenë tonat. Sa i përket informatave, ne e kemi çdo dosje të qytetarëve të dëmtuar dhe nuk kemi pasur mundësi një material aq voluminoz t' ia sjellim çdo anëtar të Kuvendit. Mirëpo nëse komisioni një qytetar nuk e ka vizituar, atëherë unë jap përgjegjësi së bashku me komisionin. Ne i kemi bërë kërkesë qeverisë edhe atë shumë herë duke filluar që nga dita e parë dhe kërkesën jemi duke e pritur për t' u realizuar dhe premtimet janë se këto kërkesa do të realizohen. Sa i përket pyetjes së z. Isufi për Lumin "Banja", po i them se tash nuk ka vërshime aty dhe mund të them se një ndër punët më të mëdha të cilat janë bërë dhe një projekt i cili është në përfundim e sipër është Lumi Banja. Aty 200 shtëpi kanë shpëtuar nga vërshimet dhe brenda 10 dite do të përfundojë në tërësi ky projekt.

Riad Rashiti- unë nuk diskutova shumë për informatën, por më tepër u koncentrova në atë se kur do të kompensohen dhe sa do të kompensohen këto dëme? Atë që e tha zv/kryetari, unë e di se çka janë informatat, por besoj se teknologjinë e dini dhe ka mundësi të dërgohet materiali në adresa elektronike.

Po thuhet se informata ka ardhur vitin e kaluar, por nuk është fare e vërtetë, më vonë komisioni e ka bërë një punë, por vlerën po e dëgjojmë sot për herë të parë. Kryetari po del me deklaratatë të cilat me dëshirë po i dëgjojmë, sepse po thuhet se vëmendja e Brukselit, Tiranës, Amerikës është kthyer në Gjilan. Besoni se po na vjen mirë kur po i thoni këto gjëra, por nga ana tjetër asgjë nuk po vjen në Gjilan, por përkundrazi asnjë lëvizje nuk ka në Gjilan. Sa i përket Lumit "Mirusha" tash jeni më objektiv, sepse nuk po jepni data, sepse disa herë keni theksuar në muajin prill, qershor etj

Nuk pati debatues të tjetër dhe me këto diskutime u mbyll debati përkitazi me këtë informatë.

2.8. Subvencionimi i Teatrit të Gjilanit

Bujar Haziri- një seancë më parë është debatuar për gjendjen e rëndë në Teatër dhe në atë seancë është nxjerr një rekomandim i cili ka të bëjë me çështjen e Teatrit. Mirëpo kryetari i Komunës e ka marrë një iniciativë që në këtë fazë që të ngrit nivelin e buxheti dhe të përgjegjësisë duke e ndarë një subvencion prej 33 mijë €. Unë kërkoj që të përkrahet dhe mirëpritet ky propozim –vendim?

Bujar Nevzadi- ne jemi për këtë dhe e mbështesim, por pak më parë mua drejtori i Teatrit më deklaroi se 50 mijë € i kanë obligime, prandaj mendojmë se kjo shumë është e vogël. Ne në seancën e kaluar kemi rekomanduar që t'ia zgjidhim problemin aktorëve të Teatrit së paku për këta 6 muajt e parë. Ne kërkojmë që së paku për këta 6 muaj të këtij viti aktorëve t'iu sigurohen pagat.

Riad Rashiti- një pyetje e kam për drejtorin: pse është ndarë nga buxheti i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik kjo shumë prej 33 mijë €? A ka ndonjë arsyeje për këtë dhe pse nuk është shfrytëzuar buxheti për Kulturë, Rini dhe Sport? Dëshira është për ta ndihmuar Teatrin, por për mua është një vendim i jashtëligjshëm, sepse nuk kemi të drejtë që mjeteve t'iu ndërrohet destinimi prej një kodi në kodin tjetër. Nëse është në rregull, ju këtë kalone, por nuk është as e arsyeshme as ligjore!

Bujar Nevzadi- kërkoj që shefi i Departamentit të Kulturës ta sjell raportin e “Flakës së Janarit”? Kanë kaluar 6 muaj këtë raport nuk e kemi, prandaj na e sillni raportin për “Flakën e Janarit”?

Nevzad Isufi- ne e kemi mbajtur një seancë të veçantë për çështjen e Teatrit dhe është diskutuar gjatë, por problemet nuk janë zgjidhur edhe më tutje, por janë aktuale. Ne kemi kërkuar që kjo Njësi mos të mbetet në mëshirën e dikujt, por të ketë buxhet të veçantë. Kjo shumë që po propozohet nuk i mbulon as nevojat se projektet që i ka Teatri, por unë kërkoj që edhe kjo të kalojë përmes procedurave, sepse nuk ka kaluar në Komitetin për Kulturë, Rini dhe Sport, por as në KPF. Jam për atë që të zbatohen procedurat për zbatim të këtij vendimi.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- nuk e di për çfarë procedura po flitet, sepse në këtë Kuvend është biseduar për Teatrin dhe është bërë rekomandimi. Rekomandimin e Kuvendit e ka zbatuar kryetari i Komunës dhe po e bisedojmë këtë rekomandim.

Në Seancën e radhës do të jetë në rend pune: ndërtimet pa leje, Flaka e Janarit, si pika të veçanta të rendit të punës.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.8 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.8 e rendit të punës : Subvencionimi i Teatrit të Gjilanit, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse opozita ishte kundër.

Riad Rashiti- nuk është në rregull të thuhet se është opozita kundër, sepse ne abstenuam për arsyeje se është shkelje ligjore.

2.9. Ndalimi i Qarkullit të automjeteve në Bulevardin e Pavarësisë gjatë orëve të mbrëmjes.

Isa Agushi- ne kemi rekomanduar që për hir të bashkatdhetarëve tanë në botën e jashtme e të cilët tash vijnë në pushim, kemi marrë iniciativë që rruga nga udhëkryqi i Teatrit deri në fund të parkut të mbyllet prej orës 19-23.30, prej 1 korrikut deri më 31 gusht. Komiteti për Shërbime Publike e ka rekomanduar këtë propozim, me një abstenim, por edhe në bashkëpunim me Drejtorinë për Shërbime Publike dhe policinë.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi – rruga e Prishtinës mbetet e hapur, kurse prej udhëkryqit deri tek fundi i parkut ndalohet qarkullimi i automjeteve për ta liruar këtë hapësirë për qytetarë si shëtitore, prej orës 19-23.30 min.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.9 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.9 e rendit të punës: Ndalimi i Qarkullit të automjeteve në Bulevardin e Pavarësisë gjatë orëve të mbrëmjes, me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan.

Të ndryshme.

Valentinë Bunjaku –Rexhepi- në pikën nën të ndryshme së pari drejtorët të përgjigjen në pyetjet të cilat i kanë marrë, kurse nëse ka ndonjë pyetje shtesë mund ta bëjnë anëtarët e Kuvendit.

Sokol Hziri- z. Haziri, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike filloi të përgjigjet në disa pyetje të shtruara nga anëtarët e Kuvendit, por pati një polemikë me kryesuesen e Kuvendit dhe hoqi dorë nga diskutimi.

Ramiz Ramadani – ne edhe kur kemi qenë grup opozitar, por edhe tash nuk kemi qenë kundër drunjve dekorativ, por përkundrazi e kemi mbështetur, mirëpo kemi qenë kundër procedurave të cilat janë zhvilluar atëherë. Mbi të gjitha dhe ajo çka është substanciale kam qenë kundër, sepse çdo herë është goditë buxheti i bujqësisë, sepse unë kam kërkuar që ky kod të jetë në Shërbime Publike në mënyrë që investimet kapitale në bujqësi mos të atakohen nga ky projekt. Kjo është esencialja, sepse ju e dini se ne e kemi filluar një projekt të vogël, por ai ndryshoi në tërësi në substancë, sepse nga drejtori i Bujqësisë na erdhi një projekt prej 256 mijë €, kurse është finalizuar me 122 mijë €.

Sa i përket mirëmbajtjes është kompetencë e Drejtorisë për Shërbime Publike duke përfshirë edhe parkun dhe mendoj se janë duke u mirëmbajtur mjaft mirë. Sa i përket dëmeve që iu kanë bërë këtyre drunjve, ky është një akt huliganesk, por kompania e ka për obligim që t' i mirëmbajë deri në vjeshtë.

Leonorë Bunjaku- në emër të një grupi të madh të mësimitdhënësve do ta ngrit një çështje shumë të rëndësishme sa i përket arsimit.. Tash e disa vjet ne jemi projekt i Korrikulës bërthamë, mirëpo në të ardhmen pritet që korrikula bërthamë të gjejë zbatim në gjitha nivelet e arsimit parauniversitar.

Ne gjatë përvojës dhe punës sonë kemi hasur në shumë paqartësi si janë moszbatim efektive në mësimitdhënie. Në korrikulën bërthamë është bërë zvogëlimi i fondit të orëve në lëndët kryesore.

Kur e them këtë e kemi parasysh lëndën e informatikës, sepse prej dy orëve është zbrit në një, pastaj vjen gjuha angleze, kurse latinishtja është larguar në tërësi. Në vend se të rriten vendet e punës të premtuara gjatë fushatës në këtë korrikulë bërthamë janë zvogëluar vendet e punës, kurse lëndët zgjedhore ndahen sipas preferencave për pa i pyetur nxënësit. Kur është fjala për vlerësimin e nxënësve në raport me shkollat e tjera nxënësve iu shkelet e drejta, sepse vlerësohen sipas fushave. Nxënësit në gjuhë angleze, gjuhë shqipe, gjuhë frënge dhe gjuhë angleze vlerësohen vetëm me një notë dhe atë me shkronjë.

Kjo metodë dhe mënyrë vlerësimi për mua është a papranueshme, sepse nxënësi që në gjysmë vjetorin e parë vlerësohet me notë të dobët, kurse në fund të vitit kaluese, ai nxënës e përsërit vitin, Këto të meta janë brengë me të cilat pritet që të ballafaqohet i tërë arsimit parauniversitar në Kosovë.

Përveç këtyre brengave janë edhe disa paqartësi, sepse të shumtën e kohës ne e kalojmë në punët administrative, humbin kohë në letra, kurse asnjë avancim në mësimitdhënie përmes këtij programi nuk kemi. Këto gjëra janë problem i ministrisë, por ne përmes Drejtorisë së Arsimit dhe Asamblesë Komunale duhet t' i adresojmë brengat tona në ministri në mënyrë që të evitohen të metat.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi –pajtohem me reagimet e zonjës Bunjaku, por këto nuk janë kompetenca të Komunës së Gjilanit, por këto vërejtje të adresohen në adresën elektronike timen dhe të drejtorit të Arsimit, kurse ne do t' i përcjellim në ministri këto brenga.

Krenare Latifi- unë e kam një reagim timin përkitazi me Komitetin e Shërbimeve Publike, sepse në një shkrim në disa portale është thënë se gjëja pozitive dhe opozitive e mbështetën unanimisht punën e mirë që po e bënë Drejtoria e Shërbimeve Publike. Unë e dëmantoj në tërësi këtë shkrim, sepse unë si anëtare e LVV nuk jam pajtuar, por kam dhënë vërejtje së pari në shpërndarje të materialeve pasi kemi hyrë në takim nga drejtori i shërbimeve Publike. Unë në emrin tim dhe të subjektit që përfaqësoj kam deklaruar se nuk kam qenë e kënaqur dhe nuk pajtohem me punët që po i bën Drejtoria e Shërbimeve Publike e sidomos në meremetimin e rrugëve të rendit të tretë, kurse në anën tjetër janë lënë anash rrugët e qytetit të cilat janë në çdo hap me gropë. Unë nuk pajtohem me këtë shkrim dhe të kihet kujdes që mos të shkruhen dhe thuhet të pavërteta. Vërejtje kam edhe për procesmbajtësen, sepse ajo deklaroi se ne shkruajmë atë

që duam dhe jo atë që dëshiron dikush, prandaj shefi i Njësise së Kuvendit duhet t' i sqaroj se cilat janë obligimet e zyrtarëve të kësaj njësie.

Isa Agushi – unë mendoj se Drejtoria për Shërbime Publike, është duke e bërë një punë shumë të mirë dhe ne kemi dal në terren pas mbledhjes e cila është mbajtur më 26, por zonja Krenare nuk ka qenë në terren dhe kemi qenë shumë të kënaqur me punën e cila është duke u bërë. Me Krenaren pajtohem me një pikë, kur e thotë se më tepër iu ka dhënë rëndësi rrugëve të rendit të tretë se të parit.

Jashar Jashari- në emër të fshatit Pogradë kërkoj një sqarim përkitazi me asfaltimin e rrugës Gjilan-Pogradë e cila ka qenë e paraparë si projekt kapital për vitin 2015. Rruga për këtë fshat është tejet e dëmtuar, por ideja për anashkalimin e këtij projekti dhe bartja e mjeteve në ndonjë projekt tjetër është një paradoks i paprecedent nga Qeveria lokale! Kërkoj sqarim pse ka ndodhur kjo ?

Një lajm i mirë është se para dy-tri seancave, kolegu Nevzad Rushiti më është drejtuar mua si kryetari i Komitetit për Shëndetësi lidhur me një analizë të gjakut e cila quhet trombo test e cila deri më tash nuk është kryer në Spitalin Regjional të Gjilanit. Kjo kërkesë ka rezultuar të jetë shumë e drejtë dhe me iniciativën që kemi marrë ministrin e Shëndetësisë ka filluar trajnimi i mjekëve dhe nga 1 qershori analizat e trombo testit bëhen në spitalin e Gjilanit. Asnjë qytetarë që ka nevojë për këtë analizë më të shkojë në Prishtinë, sepse këto analiza bëhen në Gjilan.

Nevzad Rushiti- unë jam shumë i kënaqur që qenka realizuar një kërkesë e imja e cila do t' i ndihmojë shumë qytetarëve. Me këtë rast po dëshmohet se ajo çka nuk është kompetencë e jona, ne mund vetëm të rekomandojmë, kurse rekomandimet i shqyrtojnë organet përkatëse.

Nevzad Isufi- unë e falënderoj zv/kryetarin për përgjigje, por pyetja e ime ka qenë pak më ndryshe? A ka devijim të planit, sepse dikush e ka liruar vullnetarisht hapësirën, kurse dikush ka tentuar ta uzurpojë hapësirën. A ka devijim të planit për shkak të rezistencës që ka mundur dikush ta bëjë? Përndryshe unë pajtohem se është një zgjidhje shumë e mirë. Një pyetje e kam bërë për fshati Kmetoc i cili fshat nuk ka ujë të pijshëm, por përgjigje nuk kam marrë?

Arben Maliqi- unë një çështje e kam ngrit edhe më herët, por është thënë se nuk është në kompetencë të KK-së, ajo pyetje ka qenë lidhur me Universitetin e Gjilanit. Në këtë Universitet funksionojnë katër drejtime, por e dimë që ky universitet ka hapësirë shumë të vogël. Unë kërkoj një informatë nga kryetari i Komunës se a është duke u punuar në drejtim të zgjerimit të hapësirë së këtij universitet, sepse ka qenë e paraparë që ky universitet të kalojë në këto objekte të FSK-së. Kjo ka qenë një ide shumë emirë, sepse do të ekzistojë mundësia që të hapet edhe ndonjë fakultet tjetër e sidomos kërkoj që të hapet drejtimi i Kulturës fizike, sepse do të ishte mirë për Komunën tonë dhe regjionin. Kërkoj që në seancën e radhës kryetari të na ep ndonjë sqarim për këtë rast?

Bujar Nevzadi- z. Isufi unë po i përgjigjem: “se Komuna nuk ka për obligim ta rregullojë infrastrukturën e ujit nëpër fshatra, por Komuna ka për obligim vetëm t' i punësojë familjarët e vetë”.

Sadullah Kadriu – unë e kam një vërejtje lidhur me parkingjet të cilat janë dhënë me koncesion, por Kompania “Bezi”, nuk e respekton marrëveshjen, sepse ka qenë e paraparë që të ketë parking edhe për njerëzit me aftësi të kufizuara. Unë personalisht i kam parë njerëzit me karroca të cilat nuk kanë ku të parkohen. Nuk e kam të qartë pse ndodh kjo ?

Pyetja tjetër është se para disa muajve në Kuvend është aprovuar një projekt për lagjen “Dardania” dhe unë kam qenë i bindur se pas dy-tri jave ai projekt do të fillojë, sepse është aprovuar me urgjencë. Mirëpo kanë kaluar disa muaj dhe në këtë lagje nuk ka lëvizur asgjë? Çka po ndodh me atë projekt?

Rexhep Kadriu- sa i përket pyetjes së z. Isufi për ujësjellësin në fshatin Kmetoc, ne para një jave kemi mbajtur debat me qytetarë dhe jemi pajtuar që Hidromorava të bëjë lidhjen e rjetit në gjitha shtëpitë

mirëpo aty ka mbetur projekti i papërfunduar. Ne i kemi bërë analizat, paramasat dhe parallogaritë dhe kostoja financiare e përfundimit të atij projekti është 4 mijë e 700 €. Komuna do ta përfundojë këtë projekt në afat prej dy-tri javëve, kurse banorët janë pajtuar që lidhja të bëhet me Hidromoravën në vlerë prej 180 € dhe të paguhet 30%, kurse pjesa tjetër me marrëveshje me fatura të ujit. Unë jam i bindur se Kmetoci do të ketë ujë shumë shpejtë.

Sa i përket Kampusit Universitar edhe me këtë projekt kemi filluar, sepse kemi marrë kërkesa nga rektorati që Komuna e Gjilanit ta rregullojë pjesën e planit rregullues. Për projekt nga Universiteti janë zotuar 500 mijë € dhe do të krijohen mundësi që së paku këtë vit të fillojë projekti, kurse ne në bazë të Planit rregullues jemi të obliguar që t'ia ndajmë tokën prej 7 hektarëve.

Sa i përket pyetjes së z. Kadriu për parkun “Dardania” është mbyll tenderi, janë hapur ofertat, procedurat i ndjek IOM dhe shumë shpejtë do të fillojë puna.

Me këto debate dhe vendime, seanca i përfundoi punimet në ora 15.00

Procesmbajtësi

Sali HASANI

Kryesuesja e Kuvendit

Valentinë Bunjaku- Rexhepi